



Thirrje Publike

Këshilli i Qytetit të Shkupit, me propozim të kryetarit të Qytetit të Shkupit, në seancën e mbajtur më 10.12.2025, miratoi Program me të cilin përcaktohen llojet e përdorimit të privilegjuar të transportit publik urban, kategoritë e personave me aftësi të kufizuara që kanë të drejtë për përdorim të privilegjuar të transportit publik urban, si dhe kushtet dhe procedurën për fitimin e kësaj të drejte.

Qytetarët e interesuar, personat me shikim të dëmtuar, personat me dëgjim të dëmtuar, personat me aftësi të kufizuara fizike, personat me aftësi të kufizuara intelektuale, personat me sëmundje të veshkave, personat me sjellje të spektrit autik, si dhe personat invalidë pune, pensionistët invalidë dhe invalidë të luftës, mund ta ushtrojnë të drejtën e përdorimit të privilegjuar të transportit publik urban nëpërmjet shoqatave përkatëse të qytetarëve të organizuara në territorin e qytetit të Shkupit.

Shoqatat janë të detyruara të përgatisin listë të anëtarëve që kanë marrë bileta në vitet e mëparshme dhe me deklaratë të konfirmojnë vërtetësinë e listës pa paraqitur dokumente. Për aplikantët e rinj për bileta, është e nevojshme të përgatitet listë dhe të depozitojnë dokumente (kopje e kartës së identitetit; aktvendim, konstatim dhe mendim për llojin dhe shkallën e aftësisë së kufizuar psikofizike të lëshuar nga autoritet kompetent; dokument mbi statusin: certifikatë rregullsie (për fëmijët në arsimin fillor) certifikatë për studentë me kohë të plotë, certifikatë punësimi ose certifikatë papunësie, aktvendim për fitimin e së drejtës për pension invaliditeti ose pune) jo më vonë se **data 22.12.2025**. Gjithashtu, të gjithë përdoruesit duhet të depozitojnë gjithashtu deklaratë pëlqimi për përpunimin e të dhënave personale, të nënshkruar nga aplikanti.

Shoqatat, dokumentacionin duhet ta depozitojnë në zarf të mbyllur, me shënimin: *drejtuar Seksioni për mbrojtje sociale, të fëmijëve dhe shëndetësore - për Transporti publik urban i privilegjuar*, në Arkivin e Qytetit të Shkupit, baraka nr. 16.

Për informacione shtesë përfaqësuesit e shoqatave mund të telefonojnë në numrat e mëposhtëm: 3297 – 278 dhe 3297 – 321.